

PUNIM UDHËZUES

SFIDAT EKONOMIKE 2011 PLUS

MARS 2011

FORUMI MBI POLITIKAT EKONOMIKE

Në këtë numër

- 1 **Ku jemi sot?**
- 2 **Qëndrueshmëria buxhetore**
- 3 **Zhvillimi i sektorit privat**
- 4 **Korrupcioni**
- 5 **Inflacioni**
- 6 **Privatizimi i NSHP**
- 7 **Energjia**
- 8 **Tregëtia me jashtë dhe IHD**
- 9 **Financimi**

Hyrje

Friedrich-Erbert-Stiftung dhe Instituti Riinvest nga Marsi 2011 fillojnë organizimin e tryezave të rumbullakëta mujore me tematika në fushën ekonomike, sociale dhe politike në Kosovë. Produkt final i këtyre tryezave do të jetë ky *Punim Udhëzues*, qëllimi i së cilit është nxitja e debatit mbi çështjet ekonomike për politikëbërësit, mediat, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar.

Në numrin e parë të Buletinit, ekipi hulumtues ka bërë një përmbledhje gjenerale të sfidave ekonomike në vend, gjatë vitit 2011 dhe më tej. Analizat e këtij numri përmbledhen në temën "*Sfidat Ekonomike 2011 Plus*".

Ne zgjodhëm që në numrin parë të përmbledhim një sërë faktesh ekonomike të vendit me qëllim të reflektimit mbi nevojat zhvillimore të Kosovës, aftësitë gjeneruese dhe barrierat në këtë rrugëtim. Ky reflektim më pas do të shërbejë si bazë e buletineve tjera dhe tryezave vijuese.

Ekipi hulumtues falënderon të gjithë kontribuuesit të këtij numri.

Botuar nga:

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



1. Ku jemi sot?

Sipas raporteve të UNDP-së, Kosova ka mbi **43% të papunë; 34% në varfëri** me më pak se 1.42 euro në ditë, e rreth **18% në varfëri të skajshme** me më pak se 94 cent në ditë. Këto parametra të rënduar ekonomik inkurajojnë migrimin dhe ekonominë e zezë në vend, që llogaritet të jetë rreth 1 miliard euro dhe me një evazion fiskal të pakolektuar nga mekanizmat mbledhës në vlerë prej 300-400 milion euro, vlerë kjo vjetore (Riinvest 2010).

Në një ambient të tillë ekonomik, vendi ynë vazhdon të ketë një GDP jo më të madhe se **4.2 miliard euro** (FMN 2010), Kjo vlerë është dy herë më e pakët se e Maqedonisë e Shqipërisë, tri herë se e Bosnjës dhe Hercegovinës e katër herë se e Serbisë. Produkti ynë kombëtar është indiferent ndaj zhvillimeve rajonale, dhe një vend me një produkt të tillë ka pak gjasa të impresionojë edhe me parametra të tjerë. Kjo figurë e rangon Kosovën në vendin e 158 (FMN 2010).

Për më tepër, **ritja ekonomike** (e GDP-së) prej **4.6%**, nuk ka arrit ti përmbushë kërkesat dhe nevojat zhvillimore të vendit. I konfirmuar edhe nga Raporti i Progresit 2010, ky numër vazhdon të mbetet një statistikë që nuk përkthehet dot në standardin e jetesës, meqë as papunësia e as varfëria në vend nuk kanë lëvizur nga pozicionet e tyre të rënduara. sipas Bankës Botërore, për tu barazuar në 2020-ën me vendin e parafundit në Evropë, Shqipërinë, Kosovës i duhet një ritje ekonomike vjetore prej 8-10%.

Përkundër progresit të lehtë tranzitor, ekonomia kosovare vazhdon të varet kryesisht nga burime të paqëndrueshme zhvillimore. **Shpenzimet qeveritare, remitancat** nga diaspora si dhe **asistenca financiare** ndërkombëtare vazhdojnë të jenë shtytësit kryesor ekonomik. Madje këto të fundit përbëjnë rreth 20% të Bruto Produktit Vendor.

Qytetarët kosovarë vazhdojnë të jenë më të varfrit në Evropë me një të ardhur prej kapita prej vetëm 1800 euro. Në një krahasim regjional banorët e Bosnjës kanë të ardhura për kapita rreth 5000 euro në vit, të Shqipërisë rreth 6000, të Maqedonisë rreth 7000, ndërkaq të Serbisë rreth 8000. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar 2010 me këtë të ardhur për kapita Kosova rangohet në vendin e 141 nga gjithsej 183 vende.

Nën optikën e tregtisë, vendi ynë vazhdon të ketë një disbalanc enorm në relacion të eksporteve dhe importeve. Sipas Doganave të Republikës së Kosovës, vlera totale e **eksporteve** në vitin 2010 ishte rreth **293 milion** euro; me 90% të tregjeve në BE. Në anën tjetër Kosova **importon** rreth **2.14 miliard euro** kryesisht nga tregjet e Maqedonisë, Serbisë dhe Gjermanisë. Vetëm Serbia dhe Bosnja në çdo vit importojnë në Kosovë mbi 400 milion euro në forma të rregullta dhe mbi 200 milion euro nëpërmjet ekonomisë së zezë nga Veriu i vendit (Doganat e Kosovës 2010).


Kosova vazhdon të ketë një GDP jo më të lartë se 4.2 miliard euro

2. Qëndrueshmëria buxhetore

Kalimet nga suficitet e bollshme në deficitet e thella tregojnë se Kosova po shpenzon më shumë se që ka. Në vitin 2010, të shtyrë nga konzervatizmi buxhetor, ne kemi nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare me FMN-në. Nga kjo marrëveshje vlen të theksohen 3 elemente kyçe:

- pagat në sektorin publik nuk guxojnë të kalojnë 7.4% të GDP-së, ose 290 milion euro;
- PTK duhet të shitet për 300 milion euro për të mbuluar deficitin potencial; dhe
- deficitin buxhetor duhet të mbahet brenda kornizave të lejuara të BE-së, ose 3.5% të GDP-së.

Derisa deficitin buxhetor është mbajtur brenda këtyre kornizave, fillimi i 2011 ka shënuar shpenzime marginale të papërbalueshme për kapacitetet financiare të vendit. Rritja e **pagave** në **383 milion euro** (Buxheti 2011) ka rritur pjesëmarrjen e pagave në GDP nga 7.4% në 9.1%, apo një rritje prej 23%. Buxheti i 2011 parasheh inkasimin e 1.264 mld euro dhe shpenzimin e 1.434 mld euro. ATK dhe Doganat duhet të inkasojmë mbi 18% të hyra me shume se viti i kaluar. Pagat përbëjnë 26% të shpenzimeve, mallrat dhe shërbimet 12.8%, subvencionet dhe transferet 18.9% ndërkajshëm shpenzimet kapitale 39.8%. Viti 2011 është vit rekord sa i përket investimeve kapitale. Pjesë të madhe në këtë shportë merr autostrada "Ibrahim Rugova". Kostoja e autostradës në tre vitet e ardhshme planifikohet të ndahet në 225 milionë për 2011-tën, 265 milionë për 2012-ën dhe 269 milion euro për 2013-ën.



Kostoja e autostradës vlerësohet të jetë rreth 759 milion euro

Burimi: Buxheti 2011: Kostot e autostradës në vitet në vijim

Autostrada "Ibrahim Rugova" njëkohësisht përbën edhe koston thelbësore të **investimeve kapitale** që për vitin 2011 janë **572 milion euro**, nga të cilat investohen 448 milionë euro nga niveli qendror dhe 124 milionë euro nga niveli komunal. Ministria e Infrastrukturës prinë me shportën e investimeve kapitale e që është gjithsej 263 milion euro; prej të cilave **225 milionë** planifikohen për këstin e parë të **autostradës** dhe 30 milionë për investime rrugore të mbetura nga viti 2010-të. Thënë këtë, investimet e reja në infrastrukturë rrugore do të jenë vetëm 8 milion euro, rënie kjo drastike krahasuar me vitet paraprake.

Deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2011 pritet të jetë **226 milion euro** apo rreth 5% e Bruto Produktit Vendor. Kujtojmë se normat e lejuara të deficitit buxhetor në Bashkimin Evropian nuk kalojnë 3.5%.

Vendi planifikon të inkasojë rreth **300 milionë euro** nga **shitja e asetëve** nacionale dhe një **ndihmë financiare** prej **167 milion euro** nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian. Marrja e këtyre ndihmave është vënë në risk, ndërkajshëm gjenerimi i mjeteve nga shitja e PTK-së mund të ketë vonesa serioze e me këtë të thellojë deficitin e vendit.

Krahasim me rajonin

Kosova: Shpenzimet totale për 2011 do të jenë 1 miliardë e 434 milion euro që është 232 milion euro më tepër se në 2010. Për pagat dhe medijtjet e Kosovës janë paraparë 383 milion euro apo 26.7% të shpenzimeve totale. Mallrat dhe shërbimet paraqesin vlerë prej 184 milion euro apo 12.83% të shpenzimeve për 2011. Subvencionet dhe transferet për 2011 kanë vlerë prej 272 milion apo 18.96% të shpenzimeve totale. Ndërsa shpenzimet kapitale për 2011 janë 572 milion euro apo 39.88%.

	RKS	ALB	SRB	MK
Pagat dhe medijtjet	26.7%	16.95%	23.22%	14.55%
Mallrat dhe shërbimet	12.83%	-	5.56%	10.74%
Subvencionet dhe Transferet	18.96%	0.41% *	46.78%	6.85%
Shpenzimet Kapitale	39.88%	20.15%	3.75%	14.59%

* Vetëm subvencionet

Burimi: Buxhetet Shtetërore 2011 për Kosovën, Shqipërinë, Serbin dhe Maqedonin

Për te financuar deficitin Kosova planifikon shitjen e PTK-së

Shqipëria: Shpenzimet totale për 2011 në Shqipëri do të jenë 2 miliard e € 901 milion. Shpenzimet në paga do të jenë 498 milion euro apo 16.95% të shpenzimeve totale, subvencionet 12 milion euro 0.41% të shpenzimeve totale, ndërsa shpenzimet kapitale 591 milion euro apo 20.15% të shpenzimeve totale.

Serbia: Shpenzimet totale të Serbisë për 2011 janë pak mbi 8 miliard euro. Shpenzimet për paga dhe medijtjet do të jenë 1.9 miliard euro apo 23.22% e shpenzimeve totale. Mallrat dhe shërbimet 456 milion euro apo 5.56%. Subvencionet dhe transferet në total kanë vlerën prej 3 miliard euro apo 46.82% dhe shpenzimet kapitale 307 milion euro apo 3.75%.

Maqedonia: Shpenzimet totale të Maqedonisë për vitin 2011 janë 2 miliard euro. Pagat dhe medijtjet 380 milion euro apo 14.55% të shpenzimeve totale. Mallrat dhe shërbimet 281 milion euro apo 10.74% të shpenzimeve totale. Subvencionet dhe transferet 180 milion euro apo 6.85% të shpenzimeve totale, dhe shpenzimet kapitale 381 milion euro apo 14.59% të shpenzimeve totale.

3. Zhvillimi i sektorit privat

Një ndër problemet kryesore ekonomike të Kosovës është zhvillimi ekonomik i bazuar kryesisht në shpenzimet publike. Ekonomia e vendit duhet të fillojë të mbështetet fuqishëm në zhvillimin e sektorit privat, i cili duhet të ketë rol bartës të zhvillimit ekonomik mbarënjohës. Megjithatë, sektori privat has në barriera të mëdha. Sipas Raportit të Progresit (2010) firmat në Kosove vazhdojnë të ballafaqohen me:

- sundim të dobët të ligjit,
- mungesë të energjisë elektrike,
- infrastrukturë të dobët dhe
- qasje të limituar në financim.

Deficiti i lartë tregtar në Kosovë rrjedhë si rezultat i ofertës së ulët vendore. Prodhimtaria vendore është në një nivel jo të kënaqshëm, dhe si rezultat nuk arrin ta mbulojë kërkesën e brendshme. Andaj, një nga sfidat e kryesore mbetet zëvendësimi i importeve dhe rritja e eksporteve. Mirëpo, sundimi i dobët i ligjit, ekonomia joformale, normat e larta të interesit dhe paqartësia rreth pronësisë private janë disa nga barrierat që e pengojnë drejtpërsëdrejti zhvillimin e ambientit biznesor në Kosovë, dhe rrjedhimisht rritjen e ofertës vendore për produkte.

Sipas studimit të strategjisë së industrisë, përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë e rangojnë energjinë elektrike si problemin kryesor në afarizmin e tyre, të pasuar nga konkurrenca jo-lojale dhe korrupsioni. Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike është prioritet për lehtësim të kushteve për afarizëm dhe ngritje të prodhimit vendore. Për më tepër, mbetet të punohet më shumë drejt implementimit të ligjeve dhe përmirimit të legjislaturës rreth ngritjes së kushteve për konkurrencë të shëndoshë (Riinvest 2010, Strategjia e Industrisë).

*Energjetika,
Konkurrenca jo-
lojale dhe
Korrupsioni
paraqesin
pengesat kryesore
për bizneset*

Të bërit biznes 2011

Kosova në vitin 2011 është renditur e 119-ta nga gjithsej 183 ekonomi të cilat krahasohen çdo vit në analizën krahasuese të Bankës Botërore "Doing Business". Këtë vit Kosova humbë 6 vende, krahasuar me raportin e vitit 2010-të. Sipas raportit reformat në sektorin e biznesit në vitin 2011 kanë reflektuar negativisht për arsye se me zëvendësimin e numrit tatimor të kërkuar më parë me numrin fiskal, procesi i hapjes së biznesit në Kosovë është vështirësuar dhe zgjatur më shumë. Kjo si rezultat i faktit se numri fiskal merr më shumë kohe për tu lëshuar dhe kërkon nga administrata tatimore e Kosovës që së pari të inspektoj objektin e biznesit.

- Për **fillimin e biznesit** Kosova rangohet në vendin e **163-të**, 5 vende më poshtë krahasuar me vitin paraprak. Shqipëria është e renditur e 45-ta, Bosnja zë pozitën e 160-të, Serbia qëndron e 83-ta, Maqedonia e 38-ta dhe Mali i Zi renditet i 51.
- Për tu pajisur me **leje ndërtimi** në Kosovë, duhet të pritët deri në 320 ditë dhe duhet të paguhet një çmim i cili është 8.5 here i te ardhurave mesatare për kokë banori. Për këtë arsye rangohemi në pozitën e **174**, Serbia gjendet dy pozita pas nesh kurse vendet e tjera të rajonit qëndrojnë më mire të ranguar se ne. Shqipëria renditet e 170-ta, Bosnja dhe Hercegovina renditet e 139-ta, Serbia gjendet e 176-ta, Maqedonia rangohet si e 136-ta dhe Mali i Zi rangohet i 161.
- Për **mbrojtjen e investitorëve**, raporti i Bankës Botërore na rangon në pozitën e **173**, duke shënuar kështu rënie për 1 vend nga viti i kaluar. Këtë pozitë e ndajmë me Palau, Mikronezinë, Gambinë, dhe Guinenë. Vetëm 5 vende në mbarë botën i mbrojnë më keq se ne investitorët, ndër të cilat janë edhe Afganistani dhe Venezuela. Në relacion em rajonin, Bosnja merr pozitën e 93, Serbia të 74-tën, Maqedoniatë 20-tën ndërkaq Mali i Zi të 28-tin.

- Në **zbatimin e kontratave** Kosova nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar, **155**. Anomalitë në sistemin gjyqësor dhe sundimi jo i mirë i ligjit është duke shkaktuar probleme në zbatimin e kontratave. Në raport, Kosova me 53 procedura krahasohet me vende jo të pëlqyeshme. Ky raport rendit Shqipërinë si te 89, Bosnje dhe Hercegovine 124, Serbia 94, Maqedonia 65, Mali i Zi 135.
- Sa i përket **tregtisë me jashtë**, raporti na rendit në pozitën e **130** duke pësuar ngritje prej 1 pozite nga viti i kaluar. Përsëri sipas këtij raporti gjendemi të fundit në krahasim me vendet e rajonit ku Shqipëria renditet e 75, Bosnje dhe Hercegovine 71, Serbia 74, Maqedonia 66, Mali i Zi 34.
- Në **mbylljen e bizneseve** Kosova humb këtë vit 3 vende për tu ranguar në pozitën e **31**. Në këtë tregues , Bosnja është e ranguar në vendin e 73, Serbia 86, Maqedonia 116, Mali i Zi 47.

Duke iu referuar Buletinit Tremujor Janar 2011 te botuar nga Enti Statistikor i Kosovës, në Kosovë gjatë vitit 2010 janë regjistruar në total 7729 biznese të reja kurse janë mbyllur 1363 biznese, numër i cili paraqet vitin me nivelin me të lartë të mbylljeve të bizneseve. Në tremujorin e parë të vitit 2010 u mbyllën 603 biznese kurse në tremujorin e fundit u mbyllën 210 biznese. Tremujori i fundit i vitit 2010 ishte me i ulët për regjistrimin e bizneseve të reja në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2009 për 8%.

4. Korrupcioni

Sipas Barometrit Global të Korrupsionit 2010 (Global Corruption Barometer) nga Transparency International, 73 % e të anketuarve në Kosovë besojnë se që viti 2007 niveli i korrupsionit në vend është rritur, përderisa vetëm 8 % mendojnë se korrupsioni është ulur. Raporti i njëjtë shton se në Kosovë partitë politike shihen si më të korruptuara në vend, të përcjella nga gjyqësori dhe parlamenti.

Kosova renditet e fundit në rajon për nga niveli i lartë i korrupsionit, me një koeficient 2.8 (0–3 janë të ranguara vendet në të cilat korrupsioni është shumë i përhapur), dhe në vendin 110-të në rangimin e gjithmbarshëm. Tri shtetet që gjenden para Kosovës në këtë rangim janë: **Bolivia, Gabon dhe Indonesia**, kurse tri vendet të cilat renditen pas Kosovës janë: **Ishujt Solomon, Etiopia dhe Guyana**.

Përceptimi i të anketuarve sipas këtij raporti është se sektorët më pak të korruptuar në Kosovë janë OJQ-të, Insitucionet religjioze dhe policia. Rreth 15% e të anketuarve kanë deklaruar se ata ose dikush nga të afërmit e tyre kanë dhënë mito në forma dhe institucione të ndryshme. Sipas Barometrit Global të Korrupsionit, 61 % të anketuarve mendojnë se masat antikorrupsion nga ana e qeverisë nuk kanë pasur ndonjë efekt, përderisa 32 % mendojnë se masat kanë qenë efektive.

*Kosova në 2011
rangohet e 119-ta
nga 183 ekonomi*

Një pyetje se sa në të vërtetë respondentët kanë vullnet të përfshihen në luftë kundër korrupsionit, 70 % kanë shprehur gatishmëri që të raportojnë për ndonjë rast të korrupsionit. Po ashtu rreth 70 % të tyre kanë deklaruar se njerëzit e zakonshëm mund të bëjnë ndryshime në luftën kundër korrupsionit, ndërsa gjysma e tyre kanë thënë se mund të imagjinojnë veten të përfshirë në luftën kundër korrupsionit.

Tenderët njëburimorë

Sipas raportit të Freedom House të publikuar në vitin 2010, procedurat e prokurimit dhe tenderimit në Kosovë, nuk janë transparente. Në raportin e progresit të BE thuhet se në vitin 2009 vetëm 77 % e kontratave të përgjithshme të nënshkuara janë bërë më metodën e hapur të prokurimit, shifër kjo e cila ka pësuar rritje në vitin 2010 (85 %). Vlera e kontratave të fituara përmes tenderëve njëburimor është rritur ndjeshëm nga 60 milionë € sa ishin në vitin 2008, në 200 milionë € (2009) për të shënuar një rënie të lehtë në vitin 2010 (170 milionë €). Gjithashtu vlera e përgjithshme e kontratave të fituara me anë të prokurimit publik ka shënuar rritje enorme. Vlera e këtyre kontratave përbën 22 % të GDP-së së Kosovës (FreedomHouse 2010).

Kosova në vitin 2010 rangohet në vendin e 110 në nivelin e korrupsionit

5. Inflacioni

Bazuar në të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës, indeksi total i çmimeve të konsumit (IÇK), në Kosovë është më i lartë për 1,4% në muajin janar 2011 në krahasim me muajin dhjetor 2010. Gjithashtu shkalla e inflacionit në muajin janar 2011 krahasuar me janarin e 2010 ishte 7,4%. Për muajin shkurt, IÇK në Kosovë është më i lartë për 2,2% të 2011 krahasuar me janarin e 2011. Ndërsa, shkalla e inflacionit e matur në shkurtin e 2011 krahasuar me shkurtin e 2010 ishte 9,5%. Duke iu referuar Raportit të Progresit, inflacioni vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm, duke marrë parasysh kontributin nga çmimet e ushqimeve dhe lëndëve djegëse. **Inflacioni** për vitin 2011 pritet të jetë mbi **5.3%** (ESK 2011).

Janar 2011

Ngritje të çmimeve në janarin e 2011 krahasuar me dhjetorin e 2010 ndodhën tek këto produkte: buka dhe drithëra për 3,6% me ndikim prej 0,4%, perimet 6,9% me ndikim prej 0,3%, përdorimi i paisjeve për transport personal 3,4% me ndikim prej 0,2%. Ndërsa produkte të tjera si mishi me 0,8%, vajrat dhe yndyrmat 2,6%, pemët 2,5%, sheqeri, reçeli, mjaltë, çokolata, dhe ëmbëlsirat 2,8%, veshëmbathjet 1,0%, përjetuan ngritjet respektivisht dhe secili grup kishte ndikim prej 0,1% në IÇK (Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Janar 2011).

Ndërsa nëse krahasohen çmimet e konsumit në Kosovë për janar 2011 me janarin e 2010 ndodhi një ngritje prej 7,4%. Ngritja e çmimeve ishte e dukshme te buka dhe drithërat për 33,0% me ndikim prej 3,3%, vajrat dhe yndyrat 39,9% dhe përdorimi i paisjeve për transport personal 17,2% ku secila kishte ndikim prej 1,0%. Duhani pësojë 7,0% ngritje me ndikim prej 0,5%, sheqeri, reçeli, mjaltë, çokolata, dhe ëmbëlsirat 15,4% të gjitha me ndikim prej 0,4%, veshëmbathja 3,6% me ndikim prej 0,3%. Kafja, çaji, dhe kakao 10,5%, rryma, gazi, dhe lëndë tjera djegëse 2,1% ku secila kishte ndikim prej 0,2% respektivisht. Mishi 1,2%, qumështi, djathi, dhe vezët 2,3%, pemët 4,5%, pijet alkoolike 9,9%, furnizimi me ujë dhe shërbime të ndryshme lidhur me vendbanime 9,5%, gazetat, librat, dhe materialet për zyra 6,1%, kujdesi personal 3,2%, ku secila kishte ndikim prej 0,1% në përqindjen e IÇK. Rënia e çmimeve ishte e evidente tek perimet -2,5% dhe shërbimet e transportit ajërorë -2,8%, me ndikim prej -0,1% respektivisht.

Shkurt 2011

Ngritet e çmimeve në shkurtin e 2011 krahasuar me janarin e 2011 ndodhën tek këto produkte: buka dhe drithërat për 7,2%, perimet me 14,2% përderisa secila ushtroi ndikim prej 0,7%. Sheqeri, reçeli, mjaltë, çokolata, dhe ëmbëlsirat përsuan rritje prej 7,9% me ndikim prej 0,2%. Mishi 1,4%, vajrat dhe yndyrat 4,3%, pemët 4,4%, përdorimi i pajisjeve për transportin personal 1,3%, blerja e automjeteve 5,2%, shërbimet për transport 2,0%, ku secila ushtroi ndikim prej 0,1% në IÇK (Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Shkurt 2011).

Nësë krahasohen çmimet e konsumit në Kosovë për shkurtin e 2011 me shkurtin e 2010 ndodhi një rritje prej 9,5%. Ngritja e çmimeve ishte evidente në këto produkte: buka dhe drithërat 42,2% me ndikim prej 4,3%, vajrat dhe yndyrat 46,9% me ndikim prej 1,2%, përdorimi i pajisjeve për transport personal 18,8% me ndikim prej 1,1%. Sheqeri, reçeli, mjaltë, çokolata, dhe ëmbëlsirat patën ngritje prej 24,7% me ndikim prej 0,6%, duhani 7,8% me ndikim prej 0,5%. Pemët 10,9% dhe veshmbathjet 3,6% me ndikim respektiv prej 0,3%. Mishi 2,6%, qumështi, djathi dhe vezët 2,9%, perimet 5,0%, kafja, çaji dhe kakao 11,7% ku secila pati ndikim prej 0,2%. Prodhimet ushqimore 2,4%, pijet alkoolike 10,2%, furnizimi me ujë dhe shërbime të ndryshme të lidhura me vendbanime 9,5%, gazetatat, librat dhe materialit tjera për zyre 6,0%. Ndërsa shërbimet hotelierike 2,7%, kujdesi personal 2,7%, secila me ndikim prej 0,1% në IÇK.

Ngritjet e vazhdueshme të çmimeve thelojnë varfërinë në vend

6. Privatizimi i ndërmarrjeve publike

Në dy dekadat e fundit, vende të shumta në botë (vende të zhvilluara, në zhvillim dhe në tranzicion) inicuan procesin e reformimit të industrive publike duke pasur si qëllim përmirësimin e efikasitetit të këtyre kompanive përmes konkurrencës dhe pronësisë private. Një tipar i përbashkët i këtyre politikave ekonomike ka qenë se shërbimet publike dhe projektet e infrastrukturës duhet të promovojnë përfshirjen e sektorit privat në menyrë që të përmirësohet efikasiteti, kualiteti i shërbimeve dhe mirëqenia e konsumatorit. Si rezultat, ristrukturimi dhe privatizimi i shërbimeve publike ose përfshirja e sektorit privat në ofrimin e këtyre shërbimeve, tani është gjerësisht e pranuar si një alternativë e preferuar kundrejt pronësisë publike. Me kalimin e kohës, është bërë e qartë se ndërmarrjet shtetërore të cilat ofrojnë shërbime infrastrukturore nuk janë në gjendje të bëjnë përdorimin efikas të burimeve ose të ofrojnë shërbime të kualitetit të lartë. Ato ndonjëherë parqesin shterim të madh të burimeve publike (pavarësisht nga pozita e tyre monopol) dhe zakonisht kërkojnë sasi të mëdha të burimeve publike për të përmirësuar kushtet e tyre.

Mirëpo, pasi që këto kompani ju ofrojnë qytetarëve shërbime publike dhe kanë tipare të monopolit, mënyra se si privatizohen duhet të i nënshtrohen debatit dhe pëlqimit publik. Privatizimi i NSHP në Kosovë është përqaftuar nga Qeveria pa krijuar një konsensus bazë midis palëve të interesuara. Për më shumë, qeveria ka krijuar një ndjenjë se ka përshpejtuar procesin përderisa ka dështuar në krijimin e një debati me publikun e gjerë. Ky nxitim i shoqëruar nga liria e gjerë e veprimit e qeverisë në këtë proces (pa mbikëqyrje aktive nga ana e parlamentit) ka ngritur dyshimet e publikut drejt qeverisë dhe dashamirësisë së saj në këtë proces. Në këtë shënim të shkurtër, ne do të komentojmë shkurtimisht proceset e privatizimit në rastin e aeroportit, sektorin e telekomit dhe energjisë.

Përfshirja e sektorit privat në rastin e aeroportit është përshëndetur në masë të madhe në Kosovë. Ndonëse dhënia e së drejtës ekskluzive për të operuar një objekt të aeroportit nuk është në përpuethshmëri me konkurrencën, prap gjenerimi i rezultateve konkurruese është i mundshëm nëse kompania koncesionuese zgjedhet përmes ofertimit konkurrues. Marrë për të dhënë se procesi ka qene transparent dhe konkurrues, një person do të priste që procesi të përparonte siç duhet. Mirëpo, zhvillimet e kohëve të fundit lidhur me vonesat e pashpjegueshme në marrjen përsipër të aeroportit nga koncesioneri dhe tregimet informale për një rinegocim të mundshëm të kontratës së nënshkruar kanë ngritur shqetësime.

Riinvest në vitin 2009 ka tërhequr vëmendje të veçantë në çështjen e rinegocimit të kontratës së koncesionit dhe ka diskutuar mënyrat e mundshme për të minimizuar gjasat që kjo të ndodhë. Ne paralajmëruam se përvoja nga vendet e tjera tregon se shumë koncesione zakonisht rinegociohen në favor të koncesionerit dhe në dëm të konsumatorëve apo qeverisë. Rinegocimet kanë ngjarë më shumë nëse kontrata e koncesionit nuk ishte e përfshirë në një dekret ose ligj. Në rastin e Kosovës, qeveria ka liri të plotë veprimi në koncesionimin e projekteve infrastrukturore (edhe e projekteve strategjike si aeroporti) pa mbikqyrjen e duhur nga parlamenti.

Për më tepër, ne kemi paralajmëruar se në rastet kur ofertuesit ofrijnë kushte të cilat janë 'shumë të mira për të qenë të vërteta' atëhere oferta duhet të verifikohet me më shumë kujdes. Ne mëbeshtesim iden e një roli më aktiv të parlamentit në mbajtjen e qeverisë si përgjegjëse në këtë çështje, për të siguruar se koncesioneri nuk është duke marrë një avantazh nga qeveria dhe se interesi i publikut është ruajtur.

Qeveria e Kosovës ishte shumë aktive në procedimin e privatizimit e kompanisë së telekomit (PTK). Startimi i këti procesi është paraprirë nga një mbipunësim i rëndë në PTK pa ndjekur procedurat bazike të rekrutimit dhe caktimi i antarëve të bordit të cilët ishin politikisht të influencuar, janë veprime të cilat kanë përkeqësuar gjendjen e kësaj ndërrmarje (vëreni se rënia e tregut e PTK-së vjen gjithashtu si rezultat i hyrjes së një operatori konkurrues të telefonisë mobile). Pasi PTK është një kompani fitimprurëse, argumentet e qeverisë për privatizimin kanë dështuar për të bindur parlamentin dhe publikun e gjerë se benefitet prej privatizimit të PTK-së janë më të mëdha se sa mbajtja në pronësi publike.

Projektet e kontraktuara infrastrukturore nxisin nevojën për privatizimin e PTK-së për të përmbushur shpenzimet e projekteve dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale. Privatizimi i PTK-së është pjesë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe FMN. Të ardhurat nga privatizimi, si financim pa-borxh, duhet të sigurojnë se Kosova mund të shmang huamarrjet komerciale për të përmbushur shpenzimet e lindura nga investimet kapitale të kontraktuara. Strategjia e privatizimit të PTK-së, e cila është ballafaquar me shumë opozitë në parlament, ka paraparë shitjen e 75% të aksioneve të kompanisë. Riinvest vazhdon të kundërshtojë këtë variant dhe sugjeron se Kosova duhet të shesë aksionet kontrolluese të kompanisë, prej 51% (shumicë e thjeshtë) deri në maksimum 67% (shumicë kualifikuese), të cilat bartin vlera kontrolluese respective. Aksionet e mbetura mund të shiten në fazat e mëvonshme, siç është përvoja e ekonomive të tjera në tranzicion. Privatizimi i sektorit të energjisë është përcjellur me vonesa të mëdha. Ndërsa shturja e sektorit të energjisë është përfunduar, hapat në drejtim të përfshirjes së sektorit privat në shpërndarjen dhe prodhimin ishin të ngadalshëm (nëse jo prapa).

Privatizimi i NP-ve në Kosovë është përfaqëuar nga Qeveria pa krijuar një konsensus bazik

KEK-ku ka performuar shumë dobët dhe ka kontribuar në shterimin e burimeve publike. Banka Botërore vlerëson se KEK-u ka marrë rreth 1.1 miliard euro në formën e transfereve (27 përqind e GDP-së të 2010) gjatë dekadës së kaluar nga buxheti (0.5 miliard euro) dhe donatorët (0.6 miliard euro). Vetëm gjatë vitit të fundit KEK ka pranuar një transfer nga buxheti shtetëror në vlerë prej 3.8 përqind e GDP-së. KEK-u ende nuk mundet të plotësoj kërkesën vendore dhe si rezultat rreth 10 përqind e kërkesës së Kosovës për energji është importuar vitin e kaluar me një kosto për buxhetin e mbi 1 përqind të GDP-së.

Banka Botërore vlerëson se KEK-u ka marrë rreth 1,1 miliard euro në transfere

Një strategji për të reformuar dhe siguruar pjesëmarrjen e pronësisë private në sektorin e energjisë nga ana e qeverisë synon të: (i) bashkimin e një koncesion për mihjen e linjitet me ndërtimin e një centrali të ri të prodhimit dhe (ii) privatizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Për derisa Riinvest pranon synimin e fundit, ne kemi frikë se synimi i pare mbart një rrezik të madh në krijimin e një monopoli privat në mihjen e linjitet, rrezik i cili do të dekurajonte hyrjet e reja në prodhimin e energjisë.

Për të përmbledhur, privatizimi i NSHP ka krijuar nevojën për një përfshirje aktive dhe efektive të parlamentit që do të sigurojë: (i) mbrojtjen e konsumatorëve nga keqpërdorimi i lirisë së qeverisë së bashku me ushtrimin e fuqisë të monopolist nga operatorët privat dhe (ii) mbrojtjen e operatorëve privat nga sjelljet oportune të qeverisë në të ardhme.

7. Energjetika

Prodhimi i energjisë në Kosovë është i monopolizuar nga "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK). Burimet kryesore energjetike në Kosovë janë termocentralet e thëngjillit Kosova A (5 njësi), Kosova B (2 njësi) dhe 2 hidrocentrale të vogla në Zubin Potok dhe komunën e Deqanit. Termocentrali Kosova A është ndërtuar në vitet e hershme të 60-ta ndërsa Kosova B është ndërtuar në vitet e hershme të 80-ta, të cilat ndodhen disa kilometra larg nga Prishtina.

Bazuar në të dhënat e përafërta të numërimit të popullsisë rreth 2 milion banorë, konsumi për kokë banori është 1,660 MWh për person në vit. Duhet të vihet re që mungesa e energjise elektrike stabile ka motivuar shumë që të mbështeten në gjeneratorë si burim alternativ i energjisë. Prodhimi dhe konsumi nga gjeneratorët nuk merren parasysh këtu. Burime të tjera të rëndësishme të energjisë në Kosovë vijnë nga ngrrohtorja qëndrore e Kosovës në disa nga qytetet e mëdha si: Prishtina dhe Gjakova. Gjithashtu është e rëndësishme të vihet re se një numër i madh i popullsisë mbështetet në ngrohje dhe gatim nga stufat me drunjë dhe thëngjillit (Ministria e Energjisë dhe Minierave 2010).

Ndotësit më të mëdhenjë që burojnë nga termocentralet janë CO₂, SO₂, NO_x, O₃, grimcat e ajrit, dhe sedimentet.

Të dhënat nga INKOS tregojnë që koncentrimi i SO₂, hiri (ndotje) dhe grimcat e ajrit dy herë më të larta se normat e WHO, në anën tjetër grimcat e pezulluara janë më shumë se 30 herë normat e WHO.

*Prodhimi i energjisë
ka qenë i penguar
nga problemet
kronike teknike*

Sfidat kryesore të sektorit të energjisë së Kosovës janë:

- Termocentrali i ri në përputhje me Strategjinë e Energjisë, e aprovuar nga Parlamenti, me kapacitet maksimal prej 1000 MW;
- Kooperim regjional për prodhimin, konsumimin, dhe transferin e energjisë më fokus special në Shqipëri dhe eksplorimin e energjisë me avantazhe krahasuese në mes të dy shteteve;
- Identifikimi dhe shfrytëzimi i burimeve alternative të energjisë. MEM ka identifikuar mbi 80 Hidro-centrale me sasi të përgjithshme prej 130 MW;
- Problemet komerciale në mbledhjen e borxhit dhe pagesës nga Kosovarët;
- Mbështetja në procesin e privatizimit të burimeve të energjisë dhe tërheqjen e investimeve në këtë sektor;
- Efiqineca e energjisë;
- Kujdesi ndaj mjedisit.

8. Tregtia me jashtë dhe IHD

Integrimi i ekonomisë në kushtet e tregtisë dhe integrimi i investimeve është esencial për të qenë konkurrues në tregun e BE's të cilit Kosova aspiron ti bashkangjitet. Në dekadën e fundit, ekonomia e Kosovës ka qenë shumë liberale ndaj importeve, por ajo ka dështuar të eksportoj produktet dhe shërbimet dhe të tërheqë përbrenda investimet e huaja direkte.

Statistikat e tregtisë së huaj (shiqo tabelën poshtë) tregojnë vazhdimisht deficit të lartë tregtarë, me eksporte të produkteve dhe shërbimeve llogaritet të jetë 8.2% të importeve gjatë dhjetë viteve të fundit.

Viti	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	Eksporte/Importe
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5%
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2%
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7%
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3%
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4.9%
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5%
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5%
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10.3%
2009	165,328	1,935,541	-1,770,213	8.5%
2010	294,031	2,139,534	-1,845,503	13.7%


Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës (ESK 2010)

Edhe pse ka pasë një rritje relativisht të lartë të eksporteve në raportin eksport import, të cilat janë rritur nga një bazë shumë e ulët por duket të jetë largë nga korigjimi i jobalanceve tregtarë ekonomik. Megjithatë, e ardhmja duket edhe më e zymtë nëse e konsiderojmë që një rritje në eksporte duket të jetë kryesisht e stimuluar nga eksportet e metaleve bazike, të cilat gjatë 2010 përbënin përafërsisht 63% të eksporteve totale të Kosovës (ESK, 2010).

Duke u mbështetur në eksportin e burimeve natyrale dhe/ose të produkteve të procesuara si lëndë e parë për të mbyllur deficitin e jashtëm tregëtarë nuk është as i qëndrueshëm as i favorshëm në rritjen e produktivitetit ose krijimin e punës në ekonomi. Niveli (i ulët) dhe struktura e tregtisë së jashtme duket se tregton konkurrencë të ulët të produkteve Kosovare edhe në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Shkaqet që kanë të ngjarë të jenë (të paktën pjesërisht) spjegojnë këtë problem themelor në ekonominë e Kosovës të diskutuara në seksionin 2 të këtijë raporti.

Kosova përballet me deficit tregëtarë rreth 2 miliard euro

Duke konsideruar se firmat Kosovare – si ato të ekonomive tjera në tranzicion, por edhe më tepër për shkak të problemeve politike përgjatë dekadës së fundit– kanë tendencë për të mbetur mbrapa në drejtim të teknologjisë, përdërisa në të njëjtën kohë duke u përballur me kosto shumë të lartë në financimin e investimeve, investimet e huaja direkte (IHD) të brendshme duket të jenë veqanarisht të dobishme për këtë ekonomi. Përveq sigurimit të mënyrës së financimit të investimeve përfshirë edhe punësimin, IHD mund potencialisht të kontribuojë në rritjen e produktivitetit përmes transferimeve të teknokogjisë, zhvillimit të aftësive të fuqisë punëtore dhe efekteve në firmat vendore. Deri më sot Kosova nuk ka qenë e sukseshme në tërheqjen e IHD, me përjashtim të sektorit të shërbimeve financiare dhe sektorit të telekomunikacionit. Për më tepër, për shkak (parcialisht) të krizës globale ekonomike, të hyrat e IHD në Kosovë kanë rënë gradualisht që nga 2007 kur ato arrinin kulminacionin prej rreth €440 milion.



Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës (2010)

Njëri nga faktorët për të cilin është argumentar se ka kontribuar në deficitin e lartë tregëtarë dhe në tërheqjen e pamjaftueshme të investimeve të huaja është dështimi në implementimin e marrëveshjes së CEFTA's (BQK, 2011; GAP, 2011). Problemi më i dallueshëm lidhur me CEFTA është vendimi i dy antarëve të CEFTA's, Serbia dhe Bosnia Hercegovina, të ndalojë importin dhe tranzitin e produkteve Kosovare e cla është vlerësuar të ketë shkaktuar 9.8% ulje në eksportet Kosovare dhe rritjen e kostove të transportit për eksportet tjera për 5-10% (GAP, 2011).

Dështimi në implementimin e marrëveshjes për tregti të lirë me- apo përmes-këtyre shteteve dukshëm zvogëlon potencialin e tregut të Kosovës (d.m.th tregun e vet dhe qasjen në tregjet tjera) dhe si e tillë është e mundshme të ketë efekt të dëmshëm në të hyrat e IHD në shtet.

9. Financimi

Burimet e financimit paraqesin një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë e të cilat rrjedhimisht do të ndikonin në rritjen ekonomike të vendit. Mirëpo mundësia e financimit nuk është një faktor lehtësues në themelimin e bizneseve të reja apo në ngritjen e kapaciteteve të bizneseve aktuale në Kosovë. Ky pohim rrjedh nga fakti që normat e interesit të bankave komerciale të cilat janë burimi kryesor i financimit të jashtëm të ndërmarrjeve cilësohen si mjaft të larta dhe stërngarkuese për likuiditetin e ndërmarrjeve.

Nga hulumtimi i Institutit Riinvest në nivel të industrisë së vendit del që shumica e ndërmarrjeve që kanë realizuar investime (75.8%), këto investime i kanë realizuar me mjete vetanake, përderisa 20.7% e ndërmarrjeve i kanë realizuar investimet me kredi bankare marrë nga bankat që operojnë në Kosovë. Burimet tjera të financimit përfaqësohen në pjesëmarrje shumë më të vogël ku kreditë nga bankat që operojnë jashtë Kosovës përbëjnë 0.5%, mjetet pa kthim nga donatorët e jashtëm ose OJQ-të 0.9%, huatë nga familja dhe miqtë 0.7%. Për më tepër, nga po i njëjti hulumtim, rezultate japin indikacione se shumica (81%) e ndërmarrjeve që kanë marrë kredi bankare raportojnë se kushtet janë shumë të pafavorshme ose të pafavorshme. Në këtë kuadër, shumica (74.2%) e ndërmarrjeve raportojnë se norma vjetore e interesit të paguar ka qenë prej 10-15% ndërsa afër 14% e ndërmarrjeve raportojnë të kenë paguar norma edhe më të lartë të interesit. Vetëm rreth 11% e ndërmarrjeve kanë marrë kredi me norma vjetore të interesit më të ulët se 11%. Këto të dhëna flasin për kushte mjaftë të vështira financimi gjë e cila pasqyrohet edhe në barrierat që hasin këto ndërmarrje në afarizmin e tyre (Strategjia e Industrisë, Riinvest 2010).

*Norma mesatare për
kredi gjatë vitit 2010
ishite 14.4%*

Gjithashtu, te dhënat zyrtare të sektorit financiar në Kosovë për vitin 2010 të paraqitur në raportin e BQK-së janë në raport me perceptimet e ndërmarrjeve dhe si të tilla nuk japin indikacione optimiste sa i përket uljes së normave të interesit në kredi të cilat do të mundësonin rritjen e normës së investimeve. Sa i përket lartësisë së normave të interesit, gjatë vitit 2009 Kosova printe në listën e shteteve rajonale me të cilat pretendojmë të jemi konkurrent, kurse trendi që ka vazhduar në vitin 2010 e mbanë tregun kreditor në Kosovë me norma afërsisht të njëjta me vitin paraprak. Në vitin 2009, norma mesatare e kredive në Kosovë ishte 14.4 %, përderisa të gjitha vendet e rajonit kanë shënuar norma më të ulëta të interesit në kredi (Shqipëria - 12.9%, Maqedonia – 11.9%, Serbia – 10.29%, Kroacia - 10.18%). Viti 2010 Kosovën gjithashtu e nxjerr të parën në listën e vendeve të rajonit me norma mesatare në kredi prej 14.3% që nuk paraqet ndonjë ulje të rëndësishme. Ndërsa kur analizohet në segmente të tregut kreditor, bizneset janë ato që bartin barrën kryesore të interesit në kredi pasi që këto normat të interesit për biznese kanë shënuar 16.7% kurse tek ekonomitë familjare 12.2%.

Sa i përket konkurrencës në tregun bankar, Kosova gjithashtu qëndron e fundit në listën e shteteve të rajonit sa i përket numrit të bankave të cilat operojnë në treg. Përderisa numri i bankave të cilat operojnë në shtetet e rajonit shënon një mesatare prej rreth 20 bankave, në Kosovë operojnë 8 banka komerciale. Në anën tjetër, edhe përkundër rritjes së normës së kredive joperformuese, Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon, me një normë prej 4.5% në qershor 2010. Nga vendet e rajonit, Mali i Zi e kishte shkallën më të lartë të kredive joperformuese prej 16.8%, pasuar nga Shqipëria me 12.0%, Serbia 12.0% dhe Bosnja dhe Hercegovina 8.7% (Raporti i Stabilitetit Financiar, BQK 2010). Në anën tjetër sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2010 ka realizuar fitim prej 19.4 milion Euro, që shënon rritje prej 56.8% nga viti paraprak. Sa i përket vëllimit të kredive, Kosova ka shënuar një rritje të kredisë me 9.7%, rritje kjo më e ulët sesa në vitin paraprak, kurse nga vendet e rajonit vetëm Serbia ka pasur një rritje më të lartë me 26.2%. Një situatë e ngjashme ka qenë edhe sa i përket depozitave bankare. Indikacionet e përmendura nga të dhënat bankare flasin për një performancë pozitive të tregut bankar në Kosovë, mirëpo sa është kjo performancë në harmoni me zhvillimin e bizneseve dhe një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë ekonomik që do të reflektonte poashtu një zhvillim afatgjatë të tregut bankar, mbetet një pyetje përgjigja e së cilës duhet të reflektojë zhvillim ekonomik në stadi më të larta ngase operimi me normat aktuale të interesit në kredi nuk është ndonjë gjenerator progresiv i zhvillimit të ndërmarrjeve në vend.

Që të kemi një pasqyrë sa më reale të gjendjes në tregun bankar, doemos duhet të shihen edhe faktorët që ndikojnë në gjendjen aktuale. Normat e interesit të kredive nga bankat komerciale përcaktohen nga disa faktorë të rëndësishëm ku duhet potencuar kostot operative dhe normën e riskut kreditor si dy faktorë shumë të rëndësishëm. Përderisa kostoja operative ka të bëjë me aftësinë operuese dhe ekonomizimin e shkallës në kuadër të bankave, risku kreditor përfshinë edhe aspektet të cilat nuk kontrollohen nga vet bankat por janë të lidhura me mjedisin ekonomik dhe ligjor ku ato operojnë. Në këtë aspekt duhet të potencohen problemet në sistemin gjyqësor të Kosovës të cilat rrisin riskun e realizimit të marrëveshjeve kontraktuale mes bizneseve e që rrjedhimisht rrisin koston e implementimit, si dhe problemet në sistemin kadastral të pronave që pamundësojnë hipotekimin e pronave si peng garantues në marrjen e kredive afatgjate me norma më të ulëta të interesit. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në margjinën e fitimit, apo dallimin në mes të normave të interesit për kredi dhe normave të interesit për depozita e cila në kushte të një ekonomie tregu do të duhej të tentonte kah minimizimi.

Mbi të gjitha, rreziku kreditor në Kosovë vazhdon të perceptohet në norma më të larta sesa në vendet e rajonit, mirëpo çështja se sa ka rrezik kreditor real në tregun bankar të Kosovës dhe pse ky rrezik vazhdon të perceptohet si i tillë përderisa norma e kredive joperformuese vazhdon të jetë më e ulët sesa në vendet e rajonit, e hap një debat i cili medoemos i prek disa fusha veprimi që ndikojnë në normat e interesit në kredi siç janë: konkurrenca në tregun bankar në Kosovë, efikasiteti i sistemit gjyqësor dhe gjendja e sistemit kadastral në njërin anë si dhe kapacitetet dhe serioziteti i ndërmarrjeve në përmbushjen e kushteve themelore për marrjen e kredive nga ana tjetër.

Të gjitha këto indikacione na vënë para një dileme: performanca pozitive e sektorit bankar në Kosovë po e lehtëson zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit apo po krijon stërngarkim afatgjatë financiar tek ndërmarrjet private nga i cili mund të rrezikojmë të futemi në një kurth likuiditeti financiar?

Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon, me një normë prej 4.5%

KOMENTET NGA TRYEZA

Isa Mustafa, LDK

- Ka një mungesë të strategjisë për zhvillim ekonomik. Sa i përket privatizimit të PTK-së, argumenti se PTK duhet të shitet sepse menaxhimi publik nuk është efikas nuk është një argument i fortë pasi që ne duhet të adresojmë këtë çështje me qeverisje korporative më efektive e jo me staf të mbi-ngarkuar. Një analizë kost-benefit duhet të ndërmirret në mënyrë që të kemi një proces të privatizimit i cili e mbështet zhvillimin e mirëfilltë ekonomik.
- Zhvillimi ekonomik duhet të arrijë norma më të larta në mënyrë që papunësia dhe varfëria të zvogëlohet, sepse zhvillimi ekonomik aktual nuk përkthehet në zhvillim real për sa i përket zvogëlimit të papunësisë dhe varfërisë.
- Sa i përket jo-qëndrueshmërisë buxhetore, ne rrezikojmë stabilitetin e përgjithshëm të sektorit financiar duke përdorur rezervat e BQK-së.
- Këto probleme ekonomike, të cilat duhet të diskutohen në parlament, dështojnë të diskutohen sepse mungon debati i mirëfilltë në parlament. Gjithashtu ekziston një tendenc për mbivotim në të gjitha problemet.

Naim Rustemi, AAK

- Zbatimi jo-efikas i ligjit është emruesi i përbashkët i të gjitha problemeve. Debati në parlament është i pamundshëm sepse nuk ka debat të mirëfillt apo komunikim fare.

Safet Gerxhaliu, OEK

- Unë do i kasha shtuar edhe disa pika apo probleme në këtë tryezë, si:
 - o Imazhi i Kosovës dhe rëndësia e tij për zhvillimin ekonomik
 - o Rëndësia e partneriteteve të brendshme dhe jashtme
- Çka mund të bëjnë bizneset and NVM që politika num mund të bëjë

Haxhi Arifi, BSPK

- Ne duhet të debatojmë, koordinojmë dhe përkthejmë teorinë në praktik
- Bujqësia duhet të jetë prioritet i qeverisë pasi që aty janë mundësitë për zhvillim ekonomik.

Shpend Ahmeti, FER

- Situata politike në vend e pamundëson trajtimin e sfidave ekonomike.
- Qëllimi ynë duhet të jetë fokusi në 2012 +

Visar Ymeri, VV

- Si shoqëri ne nuk duhet përqaftuar privatizimin 100%, por ne duhet të gjejmë një ekuilibër i cili do të krijojë një kohezion shoqëror

Avni Dervishi, AKR

- Në mënyrë që të shtyjmë përpara zhvillimin ekonomik ne duhet të ndjekim shembujt e vendeve tjera të cilat janë marrë me probleme të ngjajshme.

Rreth Friedrich-Ebert-Stiftung

Si organizatë private jofitimprurëse, Fondacioni Friedrich-Ebert është zotuar të promovojë idetë dhe vlerat themelore të demokracisë sociale. Demokracia sociale bazohet në të drejtat sociale të drejtat e njeriut dhe ato civile dhe synon t'i përforcojë ato. Ajo zgjeron dhe onsolidon bazën e demokracisë politike duke e përfshirë drejtësinë sociale, demokratizimin e shoqërisë, sigurinë sociale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe solidaritetin ndërkombëtar. Ajo mëton të sigurojë mundësi të barabarta në jetë dhe të drejtën për të pasur zë në çështjet e komunitetit të tyre për të gjithë yjetarët, burra dhe gra.



Fushat kryesore të veprimit tonë janë: Promovimi i demokracisë dhe mbështetja e shoqërisë civile duke ndihmuar përfaqësuesit e institucioneve politike dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe gazetarët, akademikët dhe sindikalistët. Avancimi i procesit të decentralizimit dhe mbështetja e qeverisjes lokale demokratike duke u mbështetur në debatet mbi konceptet e Qeverisjes së Mirë në nivel lokal dhe duke nxitur pjesëmarrjes aktive të të gjitha komuniteteve etnike në qeverinë lokale. Për më tepër, FES mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe të drejtë në aspekt social, duke mundësuar dialog social ndërmjet qeverisë, sindikatave të pavarura dhe organizatave të punëtorëve. Një synim tjetër është promovimi i integritit rajonal dhe ndërkombëtar duke e shqyrtuar procesin e integritit evropian bashkë me hisedarët. Veç kësaj, me organizatave të shoqërisë civile dhe vendimmarrësit debatoohen propozimet progresive të politikave për integrimin e Kosovës në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Prishtina Office
Kosovo, Prishtina, Mujo Ulqinaku str. 4/10
Tel: + 381 38 609 900 & 609 901
Fax: + 381 38 609 902
E-Mail: contact@fes-prishtina.org
Web: www.fes-prishtina.org

Rreth Institutit Riinvest

Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, operon që nga viti 1995 si organizatë hulumtuese, private jo-profitabile, me mision që ta promovoj zhvillimin modern ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Aktivitetet e Riinvestit gjatë viteve 1995-1997 ishin të fokusuar në organizimin e seminareve dhe uorkshopeve me ndërmarrës në çështje të ndryshme të mjedisit të biznesit dhe menaxhmentit të biznesit. Gjatë viteve 1997-1999 Riinvesti bëri aktivitete hulumtuese dhe përkrahëse të orientuara drejt rritjes së njohurive dhe informatave mbi faktorët vendor dhe ndërkombëtare në aspektet ekonomike të Kosovës. Gjatë periudhës së viteve 1999-2000 aktivitetet u orientuan drejt analizimit të situatave në sektorë të ndryshëm (NVM, bizneset familjare, SOE) dhe drejt një rikonstruktimit të suksesshëm. Që nga viti 2001 aktivitete kryesore përfshijnë hulumtimet mbi politikatat dhe advokime për rritjen e mjedisit të biznesit dhe krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Ne jemi instituti i parë për zhvillim dhe kërkim i llojit think tank në Kosovë ne funksion që nga viti 1995. Ne promovojmë zhvillimin modern ekonomik në Kosovë bazuar në filozofinë e ndërmarrjeve. Ne kemi bërë publikime ekonomike dhe raporte me tematika shumë të rëndësishme që përfshijnë emrat e profesionistëve më të kualifikuar. Ne kemi krijuar partneritete me organizata të ndryshme botërore, kryesisht me ato të Amerikës Veriore. Ne organizojmë seminare, konferenca, tryeza diskutimi, dhe takime me rëndësi dhe vlerë të lartë ekonomike për Kosovën. Dituria dhe eksperiencia jonë na lejon që të kualifikohemi si ekspert në çdo fushë ekonomike. Me punën tonë, gjatë 2 dekadave të fundit, ne kemi shkruar historinë e vendit tonë mbi ekonominë, tregtinë, ndërmarrësi, dhe biznes.



Kosovo, Prishtina, Zona Industriale, 10000
Universiteti AAB-Riinvest, Godina 2, K 4
Tel: + 381 38 601 320 & 601 321
Fax: + 381 38 601 321
e: riinvest@riinvestinstitute.org
web: www.riinvestinstitute.org